

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

RREGULLORE MBI BOTIMET MESIMORE-SHKENCORE
NE UNIVERSITETIN E MJEKESISE, TIRANE

Baza ligjore: Neni Nr. 14 i Ligjit «Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë», i ndryshuar; Neni 4; 15; 26; 62 i Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, neni 16 i Rregullores së Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe Rregullorja e Këshillit të Botimeve, UMT.

1. Botimet mësimore-shkencore në UMT

Botimet kryesore mësimore-shkencore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, objekt i shqyrtimit dhe miratimit nga Këshilli i Botimeve, përfshijnë: tekstet mësimore për studentë, tekstet formues dhe shkencore për ciklin e tretë të studimeve dhe për edukimin në vazhdim të profesionistëve në fushat e mjekësisë dhe monografitë. Përbëjnë objekt miratimi në Këshillin e Botimeve edhe përkthimet, ribotimet si dhe tekste të tillë si: libër ushtrimesh, praktikume laboratorike, atllase, albume, fjalorë të terminologjive mjekësore etj. Të gjitha botimet e miratuara duhet të përmbyjnë elementë të mirëfilitë të ekselencës pedagogjike dhe kërkimit shkencor. Autorë të teksteve që miratohen nga Këshilli i Botimeve janë anëtarë të stafit akademik të UMT me eksperiencë akademike dhe shkencore. Autorët e teksteve që paraqiten për miratim duhet të gëzojnë të paktën gradën shkencore Doktor.

2. Përkufizime

Përkufizimi i ,Tekstit Mësimor'

Tekstet mësimore përfaqësojnë një botim akademik me natyrë shkencore dhe pedagogjike në lëndët mësimore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe shkruhen plotësisht nga një autor, apo grup autorësh, të cilët ndajnë autorësinë e botimit për të gjithë tekstin, ose për kapituj të veçantë të tij. Tekstet mesimore përmbyjnë kryesisht materiale pedagogjike që sjellin një kontribut të ri të rëndësishëm në procesin mësimor të shkencave mjekësore dhe shërbjenë si tekst bazë për lëndën përkatëse. Ata pajisen me numër ISBN dhe duhet të botohen nga një shtëpi botuese e njohur ligjërisht.

Teksti mësimor duhet të jetë i mbështetur në programin mësimor të lëndës përkatëse, të aprovar nga dekanati përkatës. Këto tekste duhet të përmbyjnë një numër faqesh që nuk kalon 10-15 faqe për temë mësimore format A4, shkrimi Times New Roman, numri i shkronjës 12, hapësirë njëshe mes rreshtave dhe bordet e faqes normale (1,1,1,1). Autori i një teksti mësimor duhet të ketë të paktën gradën shkencore Doktor.

Përkufizimi i "Tekstit Shkencor" për studentë të ciklit të tretë të studimeve dhe për profesionistët

Tekstet shkencore përfaqësojnë një punë madhore akademike me natyrë shkencore dhe profesionale në fushat dhe disiplinat e shkencave mjekësore dhe shkruhen plotësisht nga një autor, apo grup autorësh, të cilët ndajnë autorësinë e botimit për të gjithë tekstin. Tekstet shkencore përbajnë kryesisht material të pabotuar më parë dhe sjellin një kontribut të ri të rëndësishëm në një fushë të caktuar të shkencave mjekësore; gjithashtu këto pajisen me numër ISBN. Tekstet shkencore duhet të botohen nga një shtëpi botuese e njojur ligjërisht, ku përfshihet edhe Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, për botimet e finançuara prej tij.

Autori/autorët e tekstit shkencor të hartuar për studentët e ciklit të tretë dhe për profesionistët duhet të kenë të paktën gradën shkencore Doktor dhe të janë autoritete shkencore në disiplinën që trajtohet. Këto tekste duhet të përbajnë informacion shkencor të azhornuar në fushën përkatëse, të bazuar kryesisht në „evidence-based medicine“. Tekste të tillë duhet të kenë referenca shkencore bashkëkohore të cituara në tekst dhe të referuara në bibliografinë shkencore në fund të çdo kapitulli.

Përkufizimi i „Monografisë“

Monografia përkufizohet si një trajtim shkencor original në një fushë të veçantë të një discipline shkencore. Zakonisht monografitë hartohen nga një autor i vetëm, i cili ka përvjetë dhe ka dhënë kontribut original në fushën përkatëse të dokumentuar nëpërmjet artikujve shkencore. Të paktën 70% e përbajtjes së monografisë duhet t'i dedikohet punës originale të autorit në fushën përkatëse. Përpara kërkesës për botim të monografisë, autori duhet të provojë kontributin e tij original në fushën përkatëse nëpërmjet artikujve shkencorë të publikuar në fushën që trajton monografia, ndërsa cilët, të paktën një artikull të jetë botuar nga autori në një revistë të indeksuar dhe me impakt faktor (Thomson Reuters) mbi 1 (të vitit para ardhës). Autori i monografisë duhet të ketë të paktën gradën shkencore Doktor.

3. Kriteret dhe standarde vlerësimit të botimeve

Kriteret dhe standarde vlerësimit të teksteve mësimore, monografive dhe teksteve shkencore përfshijnë:

1. Baraspeshën e paraqitjes së përbajtjes dhe mbulimit të tematikës së përshkruar,
2. Originalitetin dhe forcën argumentuese të qëllimit të studimit, të shpalosur në një përqasje inovative, me elementë shkencorë unikë, që çojnë përpara nivelin e përgjithshëm të dijeve në një fushë të caktuar,
3. Strukturën logjike, koherencën tematike dhe organizimin efektiv të punimit,
4. Respektimin e standardeve akademikë të UMT,
5. Prova të qarta të lexueshmërisë së mirë të materialit dhe të nevojave të target grupeve të përdoruesve të informacionit të paraqitur,
6. Argumentimin e qartë sesi materiali i paraqitur do të përmirësojë nivelin e dijeve, krahasuar me botimet ekzistuese,
7. Vlerat akademike të autorit, që përfshijnë listën e tij të botimeve, vlerësimet e marra, përkthimet apo publikimet e tjera të kaluara në proces,

8. Referencat dhe recensat e specialistëve të njohur të fushës së studimit,
9. Planin e fizibilitetit të botimit.

4. Recensemtët e publikimeve shkencore

Këshilli i Botimeve shqyrton paraprakisht dorëshkrimet e paraqitura për miratim, për të vlerësuar nëse janë në përputhje me procedurat dhe kriteret e miratuar. Kur janë konform kritereve Këshilli ia përcjell oponentëve (recensemtëve) sipas tipit të tekstit.

Recensemtët duhet të jenë figura të spikatura akademike dhe profesionale të shkencave mjejkësore me të paktën 15 vjet eksperiencë profesionale dhe akademike dhe titullin shkencor të paktën "Profesor i Asociuar".

Recensemtët dhe Këshilli i Botimeve mbajnë përgjegjësi për cilësinë dhe nivelin profesional dhe shkencor të dorëshkrimeve të pranuara. Recensemtët duhet ti përkasin fushave të përafërtia të studimit dhe ekspertizës me fushën e tekstit të paraqitur për botim.

5. Kërkesat për autorët

Si rregull, autorët i aplikojnë kërkesat për miratimin e dorëshkrimeve të tyre në departamentet ku ata zhvillojnë aktivitetin akademik ose në një departament të përafërt në varësi të tematikës që mbulon teksti. Një muaj pas dorëzimit, departamenti e përcjell dorëshkrimin me komentet eventuale, nepërmjet dekanatit përkatës në rektoratin e UMT. Përcjellja bëhet në protokollin e UMT dhe në shkresën përcjellëse cilësohet që kërkesa i drejtobet edhe Këshillit të Botimeve.


Autori duhet ta dorëzojë dorëshkrimin në 3 (tre) kopje të printuara në format A4, të shkruara me karakter gërmë Times New Roman dhe madhësi gërmë 12, me dubël spaciaturë në të gjitha nivelet e tekstit; së bashku me një kopje elektronike, version Word, të publikimit në CD. Organizimi i dorëshkrimit duhet të ndjekë skemën e mëposhtme:

1. Faqja e titullit, që përmban titullin e punimit, emrin e plotë të autorit/autorëve dhe përkatësinë profesionale dhe akademike të tyre,
2. Pasqyra e lëndës, që përmban titujt e kapitujve, të karakterit informues – deskriptiv,
3. Kapitujt konsekutiv të dorëshkrimit, ku çdo kapitull fillon në një faqe të re,
4. Apendikset ose Shtojcat (nëse ka të tillë),
5. Referencat.

Tabelat dhe figurat duhet të vendosen në një faqe më vehte, në vijim të tekstit të referohen.

Çdo dorëshkrim duhet të shoqërohet me një letër shoqëruese apo kërkesë ku autor/autorët konfirmojnë origjinalitetin e punimit, dakordësinë me tematikën e paraqitur, raportin me konfliktin e interesit, si edhe respektimin e Kodit të Etikës në Kërkimin Shkencor dhe të drejtës së privatësisë dhe konfidencialitetit për subjektet humanë të paraqitur, veçanërisht përfëmijët. Në rastin e teksteve mësimore, autori duhet të paraqesë edhe planin mësimor të lëndës për të cilën teksti është hartuar. Ky plan mësimor duhet të jetë i konfirmuar nga njësia kryesore përkatëse. Në rastin e kërkesës për botim të një monografie, autori duhet të paraqesë edhe evidencën e publikimit të të paktën një artikulli me impakt faktor mbi 1.

Në çdo rast autori duhet të paraqesë edhe evidencën e gradës/titullit shkencor që mbart.



Dorëshkrimi duhet të jetë i korrektuar nga ana letrare dhe i redaktuar nga ana shkencore. Formularët e nevojshëm për procesin e aplikimit të dorëshkrimeve hartohen dhe miratohen nga Këshilli Botues i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

6. Procedura e recensimit

Këshilli Botues shqyrton dhe eventualisht miraton, botimin e publikimeve në bazë të miratimit me shkrim të të paktën dy recensentëve (në rastin e teksteve për ciklin e tretë dhe porfesionistë, numri i recensentëve është 3) të fushës përkatëse. Recensentët caktohen në konfidencialitet nga kryetari i Këshillit Botues dhe identiteti i tyre mbahet i fshehtë deri në përfundimin e recensimit. Preferohet që recensentët të mos janë anëtarë të shërbimit/njësisë ku bën pjesë edhe autorët e teksteve.

Punën redaktuese për një dorëshkrim, recensentët janë të detyruar ta përfundojnë brenda një periudhe së shumti 30 (tridhjetë) ditore nga dorëzimi zyrtar i materialit nga autorë, i cili mban përgjegjësi të plotë për cilësinë dhe originalitetin e punimit. Dorëshkrimet e publikimeve shkencore i nënshtronhen recensimit prej së paku 2 (dy) autoritetesh akademike të fushës përkatëse. Recensentët janë të detyruar të shkruajnë recensionin me përfundim pozitiv apo negativ në një raport të argumentuar; të ndarë nga njëri – tjetri.

Dorëshkrimi pranonet përvazhdimin e procedurës, kur të dy dy recensionet janë pozitivë (në rastin e teksteve shkencore për ciklin e tretë të studimeve dhe për profesionistët, të paktën dy nga 3 recensentët duhet të kenë shprehur opinion pozitiv); në të kundërtën i kthehet autorit pë ripunimin e materialit, bazuar në vërejtjet e bëra. Nëse autorët nuk i plotësojnë vërejtjet e bëra nga recensentët brënda afatit të përcaktuar nga Këshilli i Botimeve për ripunimin e materialit, pa arsyё madhore të dokumentuara, konsiderohet se kanë hequr dorë nga vazhdimi i procedurës së mëtejshme të botimit.

Në rastet e mospajtimit dhe konfliktit midis autorit dhe recensentëve, vendimin përfundimtar e merr Këshilli i Botimeve, UMT.


Pëparësi botimi dhe financimi në UMT kanë tekstet mësimore të lëndëve që zhvillohen në UMT.

Botimet e tjera të tillia si përbledhje ushtrimesh, praktika laboratorike, fjalore, albume etj ndjekin procedurën e shqyrtimit dhe miratimit të tyre në Këshillin e Botimeve sipas përkatësisë së tyre në qëllimin e tekstit dédiquar studentëve apo dediquar profesionistëve të mjekësisë apo studentëve të ciklit të tretë.

7. Formatzi zyrtar i publikimeve në UMT

Publikimet e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, përbajnë në kopertinë: emrin e Universitetit; emrin e Fakultetit përkatës; emrin dhe mbiemrin bashkë me titullin akademik të autorit/autorëve; titullin e tekstit; logon e Universitetit; vendin dhe vitin e botimit. Faqja e parë e tekstit është e njëjtë me kopertinën, por e shtypur në bardhë e zi (pa ngjyra); në faqen e dytë shënohen emrat dhe titujt e recensentëve, redaktorit, të botuesit, ISBN dhe në fund të faqes numri i vëndimit të Këshillit Botues me këtë përbajtje: "Këshilli Botues i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë lejoi botimin e kësaj/këtij monografie/teksti me vëndimin Nr. _____, datë ____ ; ____ ."

Më tej vijojnë pasqyra e lëndës, që përmban titujt e kapitujve; parathënia; kapitujt konsekutivë; apendikset ose shtojcat dhe referencat. Në tekstet shkencore të dedikuara



studentëve të ciklit të tretë dhe profesionistëve, referencat duhet të vendosen në fund të çdo kapitulli. Në faqen e fundit shënohen emri, mbiemri dhe titulli i autorit/autorëve, emri, mbiemri dhe titulli i recensemtëve, redaktorit shkencor, redaktorit letrar, realizuesit kompjuterik dhe autorit të ilustrimeve grafikë dhe artistikë. Në publikim shënohen mbajtësit e të drejtës së autorit dhe fraza "Të gjitha të drejtat e autorit mbrohen më liti". Në të gjitha faqet e tekstit duhet të figurojë si *header* emri i autorit dhë titulli i publikimit. Në faqen e fundit të tekstit btohet katalogimi bibliografik i Bibliotekës Kombëtare (CIP) dhe ISBN.

8. Përkthimet në UMT

Në përkthimet e autorizuara, autori/autorët paraprakisht duhet të kontaktojë me shtëpitë botuese përkatëse apo me autorët dhe të informohen për kushtet ligjore të transferimit të të drejtës së autorit. Pas marrjes së informacionit dhe identifikimit të bartësit të të drejtës së autorit, Këshilli Botues i UMT, pas marrjes së vendimit pozitiv për përkthimin, i drejtohet zyrtarisht shtëpisë botuese përkatëse për autorizimin e të drejtës së përkthimit në gjuhën shqipe. Vetëm pas marrjes së autorizimit, autori/autorët mund të fillojnë përkthimin dhe teksti i përkthyer do të ndjekë të gjitha procedurat e përshkruara në pikat 4, 5, 6 dhe 7 të kësaj rregulloreje, deri në dhënien e lejes për botim, njëloj me publikimet e tjera.

9. Detyrimet e autorëve

Çdo publikim jashtë kritereve të përcaktuara në këtë rregullore, konsiderohët botim pa leje dhe nuk ka vlerë akademike universitare.

Pas botimit, autori është i detyruar t'i dorëzojë:

- Rektoratit UMT – 1 kopje
- Dekanatit përkatës – 1 kopje
- Këshillit të Botimeve, UMT – 1 kopje
- Bibliotekës UMT – 2 kopje
- Bibliotekës së Fakultetit përkatës – 2 kopje
- Bibliotekës Kombëtare – 3 kopje.

MIRATOI
KRYETAR I SENATIT AKADEMIK
ALI REFAT LLAZI

